

LIGJ
Nr.8396, datë 3.9.1998

**PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË GREQISË NË FUSHËN E
SHËNDETËSISË"**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë në fushën e shëndetësisë".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2214, datë 15.9.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani